



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1101/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Burim Ademi, kryesues, Milena Đjeric dhe Ferki Xhaferi, anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e Behar Thaqit, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Rahovecit, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Rahovec, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 09.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.1101/2021, paraqitur nga Behar Thaqi, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Rahovecit, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Rahovec, kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, me të cilin kanë kërkuar rinumërimin e votave në Vendvotimet VV 1624A/03R, 1608A/02R, VV 1608A/03R, VV 1602X/02D, VV 1602A/02D, VV 1626A/07R, VV 1608A/03R, VV 1608A/04R, VV 1626A/02D, VV 1604A/03R, VV 1627A/02R, VV 1627A/01R dhe VV1625A/01R.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 08.11.2021 ka pranuar apelin Anr.1101/2021 (përmes postës të datës 04.11.2021) nga Behar Thaqi, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Rahovecit, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me të cilin pretendon se në Vendvotimet VV 1624A/03R, 1608A/02R, VV 1608A/03R, VV 1602X/02D, VV 1602A/02D, VV 1626A/07R, VV 1608A/03R, VV 1608A/04R, VV 1626A/02D, VV 1604A/03R, VV 1627A/02R, VV 1627A/01R dhe VV1625A/01R ka pasur shkelje të rregullave nga komisionerët për arsye se i mungojnë votat e familjarëve dhe miqve të tij e për këtë arsye ka kërkuar nga PZAP që këto vendvotime të cekura si në apel të shkojnë në rinumërim.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se apeli i parashtruar nga Behar Thaqi, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Rahovecit, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me të cilën ka kërkuar që të bëhet rinumërimi i votave në Vendvotimet VV 1624A/03R, 1608A/02R, VV 1608A/03R, VV 1602X/02D, VV 1602A/02D, VV 1626A/07R, VV 1608A/03R, VV 1608A/04R, VV 1626A/02D, VV 1604A/03R, VV 1627A/02R, VV 1627A/01R dhe VV1625A/01R, në Komunën e Rahovecit është i pabazuar pasi që Paneli vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara siç pretendon anë apelin e paraqitur, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, e në rastin konkret, paneli gjeti se pretendimet e tij nuk janë mbështetur në prova dhe fakte konkrete por janë vetëm pretendime të supozuara andaj këto pretendime për Panelin nuk janë të pranueshme.

Kështu që Paneli vlerësoi se apeli nuk është i bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidatin.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.1101/2021 më datën 09.11.2021**

Kryesuese e Panelit

Burim Ademi



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes pranimit të këtij vendimi.